



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 507/5 prot.

Datë 24.02.2026

V E N D I M
Nr.302/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me NIPT L01314031G dhe adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2 , Km 6, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*. Nenet 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II.2. Në datën 18.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 507/2026 prot., datë 18.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6342, e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor në datën 20.02.2026, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin e KSHA nr.26/2026, datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.507/1 prot., datë 20.02.2026, lidhur me ankesën e operatorit

ekonomik ankimues "Vilnik Motors" SHPK. Referuar Vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

II.5. Vendimin e KSHA nr.26/2026, datë 19.02.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.658/6 prot., datë 20.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 507/2 prot., datë 23.02.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor në datën 20.02.2026, ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimin e KSHA nr.26/2026, datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.507/1 prot., datë 20.02.2026, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Vilnik Motors" SHPK. Referuar Vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, me arsyetimin se:

[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim dokumentet e tenderit, procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për këtë procedurë prokurimi, të publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues "VILNIK MOTORS" shpk konstaton se kriteret për përzgjedhjen e ofertës fituese janë bazuar në raportin më të mirë çmim-cilësi, që do të vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thekson se dokumentet e tenderit janë formuluar duke përmbajtur dy faza, së pari, fazën e përzgjedhjes ku përfshihen Kriteret e Vecanta të Kualifikimit dhe në përfundim të saj përzgjidhen dhe kualifikohen Operatorët ekonomikë ofertat e të cilëve klasifikohen si të vlefshme dhe së dyti, faza e përzgjedhjes së Operatorit ekonomik i cili do të shpallet fitues në varësi të raportit çmim-cilësi sipas kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese.

Në këtë kuadër, vlerësimi i procedurës së prokurimit objekt ankimi në tërësi i nënshtrohet vlerësimit të elementeve kryesore si: Çmimi (do të vlerësohet me 80 pikë) ndërsa largësia e servisit të licencuar në distancë nga Autoriteti Kontraktor përfitues jo më shumë se 60 km në

rrugë tokësore (do të vlerësohet me 20 pikë), sipas Dokumentave Standarde të Tenderit, të hartuara dhe publikuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në Dokumentet Standarte të Tenderit, Autoriteti Kontraktor, ka implementuar informacionin e nevojshëm në lidhje me kapacitetin teknik e konkretisht me disponimin e një ambjenti për ushtrimin e veprimtarisë në lidhje me shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve ku dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 2.3.3 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim, fillimisht do të shërbejë që ofertat të kualifikohen dhe më pas për shpalljen e fituesit do të vlerësohet rast pas rasti largësia e servisit të licensuar të deklaruar nga OE nga Autoriteti Kontraktor Përfitues.

Vlerësimi do të realizohet në raport me distancën në rrugë tokësore që ka servisi i licensuar, ku sa më afër të jetë me Autoritetin Kontraktor Përfitues aq më shumë pikë merr OE dhe kështu vazhdon në shkallë zbritëse.

KSHA gjykon se mbështetur në objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë me shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, kriteret kualifikuese duhet të jenë në raport dhe në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës objekt prokurimi. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të provojnë dhe të dokumentojnë se kanë aftësitë e nevojshme ekonomiko-tekniko-profesionale në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi, pra në rastin konkret kanë detyrimin që të garantojnë shërbimin e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sipas kushteve të përcaktuara nga AK të implementuara në DST, si dhe në përputhje me Specifikimet Teknike të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimimi.

Referuar Shtojcës 2 "Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit" si dhe referuar Shtojcës 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike" të dokumenteve standarte të tenderit të publikuara për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1: "Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave", Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar:

- shërbimet që do të realizohen nga Operatori ekonomik;*
- afatet maksimale të realizimit të këtyre shërbimeve;*
- si dhe detyrimi i Operatorit ekonomik oferta e të cilit do të rezultojë fituese që të ofrojë pa pagesë shërbimin e transportit të automjeteve të difektuara dhe që nuk kanë mundësi lëvizje, nga vendi i bllokimit të automjeteve deri në ambientin ku do të realizohen shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes objekt prokurimi.*

Ndodhur në kushtet ku shërbimet objekt prokurimi do të realizohen në favor të Autoritetit Kontraktor Përfitues, konkretisht Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (godina e së cilës gjendet në qytetin e Tiranës), Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se kriteri i përzgjedhjes së ofertës fituese "Largësia e servisit të licensuar në distancë nga Autoriteti Kontraktor Përfitues jo më shumë se 60 km në rrugë tokësore" nuk është i domosdoshëm, pasi distanca e vendodhjes së servisit nuk prek në thelb cilësisë e shërbimit. Në rastin konkret, referuar Nenit 87 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 45 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese" të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), aspektet e cilësisë si: meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij nuk ndikojnë në ofrimin e një shërbimi cilësor.

Në përfundim, duke mbajtur në konsideratë objektin e prokurimit si dhe referuar Specifikimeve teknike, me qëllim mbarëvajtjen e zhvillimit të procedurës së prokurimit, Komisioni i Shqyrtimit

të Ankesave gjykon se kriteri i vlerësimit të ofertës fituese (përcaktuar sipas Seksionit 4, pika 4.4 "Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi) "Largësia e servisit të licencuar në distancë nga Autoriteti kontraktor përfitues jo më shumë se 60 km në rrugë tokësore" është një kërkesë jo e domosdoshme dhe jo proporcionale, e cila duhet të hiqet nga AK me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së Operatorëve ekonomik Ofertues si dhe me qëllim nxitjen e konkurrencës ndërmjet tyre.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "VILNIK MOTORS" shpk.[...].

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar nga autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, vendimit të KSHA nr.26/2026, datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.507/1 prot., datë 20.02.2026, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe të publikojë ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK
 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro